



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku
i Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

NUMËR 17/2009
DATË: 28.08.2009

Udhëzim Administrativ

Procedura e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 42.1 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë dhe nenit 5 (c) të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ :

Neni 1

Qëllimi

1. Ky Udhëzim administrativ ka për qëllim që ta përcaktoj procedurën e zgjedhjes dhe emërimin e personelit arsimor në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në tërë territorin e Kosovës.

Neni 2

Shpallja e konkursit

1. Shpallja e konkursit për zgjedhjen e personelit arsimor në shkollat e komunës përkatëse, të bëhet nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA).
2. Kandidatët për vendin e punës së shpallur në konkurs, konkurrojnë në drejtorinë komunale të arsimit.

Neni 3

Komisioni për zgjedhjen e personelit arsimor

1. Në çdo komunë do të themelohet komisioni për zgjedhjen e personelit arsimor.

Komisioni përbëhet nga :

1.1. Dy përfaqësues të Drejtorisë Komunale të Arsimit

1.2. Drejtori i shkollës përkatëse.

Neni 4

Procedura e zgjedhjes së personelit arsimor

1. Personelin arsimor në shkollë e zgjedh Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në bazë të rekomandimit të komisionit për zgjedhjen e personelit.
2. Komisioni për zgjedhjen e personelit arsimor do të shqyrtoj të gjitha kërkesat e Kandidatëve, dhe në bazë të kriterëve (shkalla e përgatitjes profesionale, rezultatet në punë, përvoja e punës në arsim etj) do të përpilohet një listë e ngushtë prej tre(3) kandidatëve për intervistë.
3. Komisioni do t' i intervistoj kandidatët e listës së ngushtë një nga një dhe do t' i vlerësoj ata në bazë të kriterëve.

Neni 5


Dispozitat shfuqizuese

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ, shfuqizohet Udhëzimi administrativ nr.18/2003- Procedura e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë.

Neni 6

Hyrja në fuqi

1. Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.



Enver Hoxhaj, ministër